CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

# Arka e sigurimit shëndetësor: Sigurimi bazë



Fotografia: Barbara Graf Horka

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 1

# Është sigurimi bazë në arkën e sigurimit shëndetësor i detyrueshëm?



Fotografia: © tackgalichstudio/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

- Sipas ligjit të sigurimit shëndetësor (KVG-Krankenversicherungsgesetz), është mbulimi bazë për të gjithë personat me banim në Zvicër (të rritur, fëmijë dhe fëmijë të vegjël) i detyrueshëm.
- Për lidhjen e sigurimi bazë ekziston një afat prej 3 muajsh pas ardhjes në Zvicër ose pas lindjes së një fëmije.
- Arka e sigurimit shëndetësor nuk lejohet të refuzojë një pranim me mbulimin bazë. Ajo nuk lejohet të shtrojë asnjë pyetje për gjendjen shëndetësore.
- Kjo kartë trajton vetëm sigurimin bazë. Merrni kontakt direkt me arkën e sigurimit shëndetësor për sigurimin shtesë.

Karta 2

# Si kontaktoj unë me arkën e sigurimit shëndetësor?



Fotografia: Reto Albertalli

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

– Zgjidheni arkën e sigurimit shëndetësor në këtë mënyrë që agjencia të jetë afër; në rast pyetjesh problemesh ose vështirësish të shkohet atje dhe të merren informacione dhe të sqarohet duke biseduar. Është e mundur të merren informacione nëpërmjet telefonit, por kërkoni një përgjigje me shkrim. Në raste mosmarrëveshjesh: kërkoni përgjigje me shkrim.

– Në rast vështirësish, për të paguar primet, merrni menjëherë kontakt me arkën tuaj të sigurimit shëndetësor dhe bëni kërkesë me shkrim për një marrëveshje për pagesën ose merrni kontakt me një vend këshillimi për borxhet dhe buxhetin.

E rëndësishme: probleme të veçanta nuk shpërbëhen vetë në ajër. Arkat e sigurimit shëndetësor iu përmbahen bazave të ligjit.

Karta 3

# Kontributet e marra përsipër nga arka e sigurimit shëndetësor (KVG)



Fotografia: ©INTERPRET

Lista e mëposhtme është një përzgjedhje e vogël e kontributeve, të cilat merren përsipër nga sigurimi bazë: kontributet e plota të pyeten tek arka e sigurimit shëndetësor.

– Trajtime ambulante mjekësore: mjekë, kiropraktikus
– Shtatzëni, lindje, rast emergjent, «Spitex»-i, streha spitalore për kujdesin ndaj të moshuarve, parandalim (vaksinat).
– Medikamente do të merren përsipër vetëm me recetë mjekësore. Të ashtuquajturat preparate për stilin e jetës [lifestyle] (vitamina, sipradin, mebukainë, pilula parandaluese për shtatzënie etj) nuk merren përsipër!

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel
© Caritas Schweiz

Karta 4

# Pjesëmarrja e personit të sëmurë në kostot në rast sëmundjeje




Fotografia: © Schlierner/Fotolia.com

Këto kosto duhet t'i paguajë personi i siguruar në çdo rast vetë gjatë një viti:

- Primi mujor (shih kartën 5)
- Ekskluziviteti mujor (shih kartën 6)
- Kontributi vetjak mujor (shih kartën 7)
- Kontributi për qëndrim në spital (shih kartën 8)



© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 5

# Çfarë duhet të dimë ne mbi primin tonë?



Fotografia: © Schlierner/Fotolia.com

– Primi është një kontribut që detyrohet rregullisht, për të paguar arkën e sigurimit shëndetësor. Kategoritë e moshës me prime të ndryshme: 0–18 vjeç, 19–25 vjeç, nga 26 vjeç.

– Primet janë po ashtu sipas çdo kantoni dhe bile sipas regjionit brenda një kantoni në lartësi të ndryshme. Primet ndryshojnë përveç kësaj nga një arkë sigurimi shëndetësor tek tjetra.

– Primet duhet të paguhen paraprakisht.

– Miratimi i primeve nëpërmjet kantonit. Informacione dhe shtrimi i kërkesës tek vendi zyrtar përkatës (informacione të merren tek drejtimi i filialeve).

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

# Karta 6

## Çfarë është një eksluzivitet? Për çfarë duhet të kem unë kujdes?




Fotografia: © Schlierner/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

- Eksluziviteti është një kontribut i zgjedhshëm, të cilin personi i siguruar në rast sëmundjeje duhet ta paguajë në çdo rast.
- Eksluzivitetet:
  - Fëmijët: CHF 0.– (100.– / 200.– / 300.– / 400.– / 500.– / 600.–)
  - Të rriturit: CHF 300.– (500.– / 1000.– / 1500.– / 2000.– / 2500.–)
- Këshillim: zgjidhni kontributin më të ulët të ekskluzivitetit. Nëse do të zgjidhet një eksluzivitet më i lartë, për shembull CHF 500.– (të rritur) dhe CHF 200.– (fëmijë) do të duhej që kontributi prej CHF 1400.–, i cili në rast sëmundjeje duhet të paguhet vetë, të ekzistojë në një llogari kursimi.

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 7

# Çfarë është kontributi vetjak?




Fotografia: © Silvana Comugnero/Fotolia.com

- Kontributi vetjak është shuma, të cilën personat e siguruar, në të gjitha kostot në rast sëmundjeje, duhet ta paguajnë vetë.
- Për t'u paguar janë më së shumti 700.– CHF/vit për të rritur dhe 350.– CHF/vit për fëmijë nën 18 vjeç (dhe maksimalisht 1000.– CHF në rast të tre ose më tepër fëmijësh).

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 8

# Cilat kontribute paguan sigurimi bazë i arkës së sigurimit shëndetësor në rast të një qëndrimi në spital?



Fotografia: © Tom Wang/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

- Marrja përsipër e kostove në spitalet më të shumta të Zvicrës (në asnjë klinikë private). Sigurimi bazë i merr përsipër të gjitha kostot në pavijonin e përgjithshëm, kjo do të thotë:
  - Dhomë me shumë krevate
  - Asnjë zgjedhje e lirë mjeku
  - Kontribut në kostot e qëndrimit në spital
- Si rregull do të merret përsipër trajtimi në një spital publik i kantonit të banimit tuaj. Që nga viti i 19-tëi moshës duhet të paguhen vetë 15.– CHF në ditë për strehimin në spital. Përjashtime: Barrë-lindja dhe të rinj të rritur në formim profesional (deri në 25 vjet).

Karta 9

# I mbulon arka ime e sigurimit shëndetësor kostot në rast sëmundjeje jashtë shtetit?



Fotografia: © Markus Mainka/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

- Gjatë udhëtimeve për jashtë shtetit të merrni me vete gjithmonë kartën (evropiane) të sigurimit shëndetësor (është si rregull karta e njëjtë si për Zvicrën).
- Shpesh, mbulimi i sigurimit të shërbimit për sëmundje jashtë shtetit është i pamjaftueshëm. Prandaj mund të jetë i arsyeshëm, për pushimet të lidhet një sigurim për udhëtimet.
- Është e këshillueshme, para një udhëtimi jashtë shtetit të sqaroni saktësisht kontributet.

Karta 10

# Nëna ime (ose babai) më viziton mua në Zvicër: Çfarë bëhet, nëse ata sëmuren?



Fotografia: Andreas Schwaiger

- Të lidhet një sigurim në vendbanimin e nënës (ose babait)!
- Të lihet të sigurohet nëna (ose babai) në Zvicër tek arka vetjake e sigurimit shëndetësor për ditët përkatëse të qëndrimit.
- Në raste emergjente, të merret eventualisht kontakt me shërbimin social të spitaleve regjionale.

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

Karta 11

# Unë jam shtatzënë!
# Cilat të drejta dhe detyrime kam unë?



Fotografia: ©pressmaster/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

Cilat kontribute marr unë?

- 7 kontrolle rutinë dhe 2 kontrolle me ultra tinguj nëpërmjet një mjeku ose një mamie. Në rast të një shtatzënie me rrezik, aq shpesh, sa të jetë e nevojshme. Parapërgatitja e lehonisë: 100.– CHF merren përsipër për një mami. Lehonia do të merret përsipër plotësisht. Pas lehonisë: 1 kontroll dhe 3 këshillime për dhënien gji (nuk duhet të paguhet asnjë ekskluzivitet dhe asnjë kontribut vetjak.
- Është e arsyeshme, që në muajin e tretë të shtatzënisë, të lidhet një sigurim për të sapolindurin. Primi është i pagueshëm që nga lindja.

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 12

# Jam unë i mbuluar [nga sigurimi] në rast aksidenti?



Fotografia: ©Henry Czauderna/Fotolia.com

– Nëse ju punoni të paktën 8 orë në javë, ju do të siguroheni nga punëdhënësi juaj kundër aksidenteve gjatë punës dhe jashtë punës sipas ligjit për sigurimin shëndetësor ndaj aksidenteve.

– Nëse ju nuk keni asnjë punëdhënës, ju jeni siguruar ndaj aksidenteve tek arka e sigurimit tuaj shëndetësor.

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

# Karta 13

## Kush e paguan dentistin?



Fotografia: © Photographee.eu/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

- Kostot për shërbimin e dhëmbëve merren parimisht përsipër.
- Sigurimi paguan dentistin vetëm në rast të një ndërhyrje si pasojë e një aksidenti ose në rast të një sëmundjeje të rëndë të sistemit të përtypjes.
- Secili megjithatë mund të lidhë një sigurim shtesë (për të rritur i shtrenjtë).
- Nëse është i dëshiruar, mund të zgjidhet për fëmijë që nga lindja një sigurim shtesë, i cili merr përsipër për shembull korrigjimet e shtrenjta të pozicioneve të dhëmbëve (i leverdishëm).
- Trajtime të caktuara të dhëmbëve merren përsipër nga sigurimi vetëm pas një afati të fiksuar në kushtet e kontratës.

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 14

# Syze dhe përjashtime të tjera



Fotografia: © Fotofreundin/Fotolia.com

– Për fëmijë deri në përfundimin e vitit të 18-të të jetës paguan sigurimi bazë në xhamet e syzeve dhe në thjerrëzat e kontaktit 150 CHF në vit. Për të rritur nuk merret përsipër asnjë kosto nga sigurimi bazë. Sidoqoftë mund të lidhet një sigurim shtesë.
– Mjete ndihmëse të tjera, të cilat merren përsipër nga sigurimi i detyruar i shërbimit për sëmundje i sqaroni ju lutemi direkt tek arka e sigurimit shëndetësor.

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel
© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 15

# Kosto të transportimit (ambulancë, helikopter) të mara përsipër nga sigurimi bazë




Fotografia: ©k_rahn/Fotolia.com

– Transporti: 50 % të kostove, më së shumti megjithatë 500.– CHF për çdo vit kalendarik.

– Shpëtimi: 50 % të kostove, më së shumti megjithatë 5000.– CHF për çdo vit kalendarik.

– Këshillë: Lidhni një sigurim shtesë ose bëhuni përkrahës i «REGA» (Helikopteri zviceran i shpëtimit, www.rega.ch).



© Caritas Schweiz

CARITAS Schweiz Suisse Svizzera Svizra

femmesTISCHE

Karta 16

# Të kuptohet fatura e mjekut dhe e spitalit
# Si të paguhet?



Fotografia: © Thomas Francois/Fotolia.com

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz

Rikthimi i kostove të mjekut

– Llogaritja e ekskluzivitetit dhe kontributit vetjak
  – Bashkëngjitni fletët e llogaritjes
  – E rëndësishme: Dërgoni menjëherë faturën origjinale tek arka e sigurimit shëndetësor
– Mos harroni, përgatitni një kopje

→ Shih skemën e veçantë

Karta 17

# Ndërrim i arkës së sigurimit shëndetësor: Kur dhe me cilin afat?

santésuisse

Die Schweizer Krankenversicherer

Les assureurs-maladie suisses

Gli assicuratori malattia svizzeri

- Arka e sigurimit shëndetësor mund të ndërrohet gjithmonë në fund të vitit. Afat një mujor për prishjen e kontratës (më së voni më datën 30 nëntor) për në fund të dhjetorit. Kujdes: më së voni në ditën e fundit të punës së muajit nëntor i siguruari duhet të ketë marrë letrën (afate të mëtejshëm të prishjes së kontratës të sqarohen direkt tek arka e sigurimit shëndetësor)!
- Ju duhet të shkruani dy letra: njërën, për të prishur kontratën me arkën tuaj të sigurimit shëndetësor, dhe një tjetër për t'i njoftuar arkës së re hyrjen tuaj atje.
- Kujdes: Me qëllim që ju të prishni kontratën dhe të mund të ndryshoni arkën e sigurimit shëndetësor ju duhet patjetër t'i kini paguar të gjitha faturat.

Një projekt i «Caritas» Zvicër në bashkëpunim me moderatorët FT, Biel dhe effe Biel

© Caritas Schweiz